



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe neneve 4, 6 dhe 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE**

- I. **OBLIGOHET**, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej 2,070.00 € (dy mijë e shtatëdhjetë euro) për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e 4 (katër) parashtruesve të kërkesave (persona fizik) për periodën shtator 2020 konform Vendimeve të tyre individuale për mbështetje financiare sipas listës së bashkangjitur në shtesë të këtij Vendimi.
- II. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogaritë bankare personale të parashtruesve të kërkesave.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista me të dhënat e parashtruesve të kërkesave në formë tabelare për muajin shtator 2020.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400-43375
Lipjan, më 30.09.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



